



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu

Nr. i prot. 2103 Më 05.07 2024  
Br. prot.            Dt.             
RAHOVEC - ORAHOVAC



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**

**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec**



**Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm  
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam  
Department of Economy, Development and Tourism**

---

# Raporti i punës

## Janar–Qershor, 2024



**Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo**

**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec**



**Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm  
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam  
Department of Economy, Development and Tourism**

<b>DATË /A:</b>	<b>05.07.2024</b>
<b>PËR/ZA/TO :</b>	<b>z.Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit</b>
<b>NGA/OD/FROM:</b>	<b>z.Erhan Morina, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm</b>
<b>LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Raport i punës për periudhën janar-qershor 2024</b>



-Gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2024, DEZHT-i ka bërë regjistrimin e të gjitha subjekteve afariste në excel, poashtu është bërë edhe kalkulimi i ngarkesave për vitin 2024.

-Për periudhën raportuese Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka përgatitur disa pika drejtuar Kuvendit Komunal në Rahovec:

- Informatë mbi menaxhimin asetëve komunale për vitin 2023;
- Vendimi për dhënjën në shfrytëzim përmes shprehjes së interesit, pronat komunale, për vendosjen e paneleve solare;
- Vendimi për dhënjën në shfrytëzim përmes ankandit publik të të parcelës te depot e matreksit në Xërxë;
- Vendimi për dhënjën në shfrytëzim përmes ankandit publik të shtëpisë së verërave.

**Investimiet Kapitale:**

- Me datë 26.02.2024, është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, për realizimin e projektit "Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi Qytetin e Rahovecit". Ky projekt është dy vjeçar dhe vlera bashkëfinancimit është: 320,117.00€, ku 200,000€ do ti ndaj MZHR dhe 120,117.00€ Komuna e Rahovecit;
- Me datë: 15.03.2024 është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për financimin e parkut industrial në Opterushë, faza e dytë. Vlera e bashkëfinancimit për këtë fazë është: 1,013,360.36€;

**KOMUNA RAHOVEC**

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

- Poashtu mërrëveshje bashkëpunimi kemi edhe me Ministrinë Administrimit të Pushtetit Lokal, për bashkëfinancimin e projektit “Ndërtimi i Shtandëve Mobile, për Mbajtjen e Panairëve” vlera e këtij bashkëfinancimi është 40,000.00€. Ky projekt pritet të përfundoj brenda vitit 2024;
- Në projektin: “Ndërtimi i Lokaleve Afariste Zejtare në Rahovec”, kanë përfunduar pothuajse të gjitha punimet në objekt, ka mbetur të realizohet edhe pozicioni i rregullimit të oborrit, i cili sipas planit dinamik pritet të përfundoj brenda muajit në gjysmën e parë të muajit korrik.
- Projekti: “Ndërtimi i Sheshit në Qendër të Qytetit” në bashkëpunim me KEDS-in, kanë vazhduar punimet në sistemimin e kablove nën tokë. Ky projekt pritet të përfundoj në gjysmën e parë të muajit korrik 2024.

#### Sektori për Ekonomi:

-Në tre mujorin e parë të vitit 2024, janë përgatitur aktvendimet për 738 biznese të cilat sipas kodeve ekonomike ngarkohen me taksë afariste. Ndërsa për periudhën janar-qershor janë dërguar 257 vërejtje për të gjitha ato biznese të cilat kanë pasur vonesa në kryerjen e pagesave në taksa afariste.

#### Të hyrat dhe ngarkesa në taksë komunale;

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksë komunale, janar-qershor 2024	52,833.40€

#### Sektori për Zhvillim;

-Evidenca e të hyrave dhe ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit, sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt.

Në periudhën janar-qershor 2024, janë lëshuar gjithsej 42 pëlqime të punës dhe janë dërguar 32 vërejtje për bizneset të cilat kanë pasur vonesa në pagesat e qirasë, konform dispozitave ligjore që përcakton rregullorja për taksa komunale 01 NR: 80/20.

#### Të hyrat nga qiraja;

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiraja, janar- qershor 2024	40,340.30€

#### Zyra e QKRB-së:

**KOMUNA RAHOVEC**

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

-Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës. Evidenca e regjistrimit të bizneseve të komunës së Rahovecit, sipas bazës së programit online të ARBK-ës, mbahet në mënyrë të rregullt.

**Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhën janar-qershor 2024:**

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Nr.</b>
1	Biznese të reja	92
2	Informata të ndryshme	126
3	Vërtetim Individual	14
4	Shuaje të biznesit	10
5	Shuarje të njësis	03
6	N.U.I.	33
7	Njësi e re	01
8	Çerteikata duplikat	04
9	Ndrrimi i tipit të biznesit	03
10	Ndryshime në biznes	60
11	Punë të tjera me palë	27
	<b>Gjithsej lënd të përfunduara</b>	<b>373</b>

#### **Menaxhimi i Asteteve komunale**

-Të gjitha transaksionet që kanë ndodhur në periudhën janar-qershor, janë regjistruar me kohë në sistemin e-pasuria dhe SMFK dhe regjistrimi i tyre bëhet në vazhdimësi.

#### **Sektori i Turizmit**

-Përmes bashkëpunimit me UNDP, është mundur praktikë 3 mujore për 3 kandidat, dy nga kandidatët janë angazhar në Komunën e Rahovecit dhe një në shoqatën Hareja.

-Mbajtja e trajnimit "Standing Working Group (SWG) in the South-Eastern Europe", lidhur me Promovimin dhe Marketingun e Turizmit përmes rrjeteve digjitale.

-Poashtu, në vazhdimësi janë kryer punë të cilat i shërbejnë promovimit të turizmit në Komunën e Rahovecit .

**Me respekt!**

**KOMUNA RAHOVEC**

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm